

Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj, ka sjellë Konkluzion për lëndën **P.nr.176/19**, mbi shitjen e paluajtshmërisë së hipotekuar në favor të bankës BKT, e cila evidentohet sipas Çertifikatës së pronës me numër: 11-942/03-0296247/19, parcela me numër **P-71914059-01973-3**, me sipërfaqe prej 237 m², e cila gjendet në vendin e quajtur "Kolonija e Re" Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Kadastrale Prishtinë, e evidentuar në emër të pronares Sabile Bajgora, e bllokuar/hipotekuar në favor të kreditorit Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.

Kjo pasuri e përshkruar si më lartë do të shiten përmes Ankandit të Parë Publik, në mbështetje të plotë të dispozitës së Nenit 227 të LPP-së, me qëllim të sigurimit të mjeteve për të përmbushur detyrimet që debitorët Kompania N.T. Blue (dhe të tjerët), kanë ndaj kreditorit – **Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.**

» Vlera e paluajtshmërisë është vlerësuar në shumën prej: **460,000 €** (katërqind e gjashtëdhjetë mijë) Euro, pasuri e cila në këtë ankand të parë të shitjes publike mund të shitet nën vlerën e përcaktuar, por jo nën 1/2 e vlerës së përcaktuar.

- Data e Ankandit të Parë Publik: **23.11.2020**
- Koha e shitjes – ora: **09:30**
- Vendi i shitjes: **Përmbarues Privat Destan Bujupaj, Rr. Perandori Dioklecian, Obj. 4, Nr. 15, Prishtinë.**

Të gjithë të interesuarit duhet të deponojnë tek përmbaruesi privat shumën prej 10 % të vlerës së cekur të paluajtshmërisë por jo më shumë se 5,000 Euro në emër të kaucionit, para se të fillojë shitja, por jo më vonë se data 22.11.2020, me të drejtë të kthimit të kaucionit pas përfundimit të ankandit, ofertuesve të pasuksesshëm.

Për informata me të hollësishme, ju lutem, kontaktoni në tel: 038 666 666; 045/700-790.

Prishtinë, 2020



038 666 666 | www.bkt-ks.com

Ne jemi gjithmonë këtu!